



Në përputhje me autorizimin e dhënë në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 si dhe nenin 12 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 13 janar 2012, miratoi:

Rregullore Mbi Minimumin e Rezervave të Bankës

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore nxirret për të caktuar minimumin e kërkuar të rezervave për tu mirëmbajtur nga të gjitha bankat në Kosovës ashtu siç parashihet me nenin 12 të Ligjit për BQK-në.

Neni 2 Baza e rezervës

Kërkesa e rezervës të bankës për çdo periudhë të mirëmbajtjes është e llogaritur si një përqindje e obligimeve të cilat vijnë më poshtë, e që kanë afat maturimi deri në një vit:

- (a) Depozitat
- (b) Huamarrjet
- (c) Letrat me vlerë

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, llogaritë rrjedhëse të depozitave dhe llogaritë e kursimit janë konsideruar të kenë afat maturimi më pak se një vit.

Neni 3 Raporti i minimumit të kërkuar të rezervës

BQK-ja duhet të përcaktoj përqindjen e bazës së rezervës së aplikueshme të bankës që është e kërkuar të mirëmbahet (raporti i minimumit të kërkuar të rezervës). BQK-ja mund të përcaktoj këtë raport në çdo kohë para ose pas periudhës së mirëmbajtjes të cilës i takon. Me nxjerrjen e kësaj Rregulloreje, raporti i minimumit të kërkuar të rezervës duhet të jetë 10 përqind.

Neni 4 Kalkulimi i rezervës së kërkuar

Baza për llogaritjen e minimumit të rezervës së kërkuar duhet të caktohet si shumë mesatare e balancës ditore në llogaritë e institucioneve që marrin depozita për çdo ditë kalendarike të muajit të mëparshëm kalendarik.

Neni 5

Periudha e mirëmbajtjes së rezervës

Periudha për të cilën bankat kërkohen që të mirëmbajnë minimumin e rezervës duhet të jetë një muaj kalendarik dhe duhet të fillojë nga dita e pestë kalendarike pas periudhës bazë raportuese dhe do të përfundojë në ditën e katërt kalendarike të periudhës pasuese, që do të quhet periudha e mirëmbajtjes së rezervës.

Neni 6

Mjetet rezervë

Mjetet me të cilat banka mund të plotësojë kërkesën për rezervë janë depozitat e saj në BQK dhe pesëdhjetë përqind (50%) e parave të gatshme që mbahet në trezorin e saj. Megjithatë, depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se gjysma e minimumit të rezervës së aplikueshme të likuiditetit. Paratë e gatshme të pranueshme duhet të jenë në valuta të Euros si dhe valuta tjera të këmbyeshme.

Neni 7

Kërkesa e mjeteve rezervë është kërkesë minimale ditore

Raporti i rezervës si dhe bilanci me BQK-në gjithmonë duhet të jetë barazi ose të tejkalojë shumën e rezervës së kërkuar. Me fjalë tjera, nuk ka më balance mesatare për tu mirëmbajtur, por janë minimumet të cilat duhet të mirëmbahen çdo ditë.

Neni 8

Interesi në minimumin e rezervës së kërkuar

Shkalla e interesit do të përcaktohet kohë pas kohe nga BQK-ja.

BQK-ja paguan interes për bilancet e mbajtura në BQK-në deri në shumën 10% të minimumit të raportit të rezervës së kërkuar.

Kjo pagesë duhet të kreditohet në llogaritë e kliringut të bankës në BQK brenda pesë ditëve pune, në vazhdim të fundit të periudhës së mirëmbajtjes të cilës i takon.

Neni 9

Kërkesat e kalkulimit dhe raportimit

Banka duhet që të kalkulojnë rezervën e kërkuar dhe duhet që të dërgojnë raportin për depozitat e saja të aplikueshme në BQK në pajtim me orarin e caktuar nga BQK-ja. Në mënyrë që të kalkulohet mesatarja e bazës së rezervës, duhet që të përdoret bilanci i mbyllur në fund të ditës së punës.

Neni 10

Dënimet

Dështimi i një banke që të mirëmbajë minimumin e rezervës së kërkuar ditore, do të rezultojë në gjoba dhe dënime të duhura të përcaktuara në përputhshmëri me kompetencat e BQK-së sipas nenit 67.2 të Ligjit mbi BQK-në. Dështimi i përsëritur mund të rezultojë në përjashtimin nga

sistemi i pagesave derisa të arrihet prapë pajtueshmëria. Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare të BQK-së duhet të njoftohet menjëherë për të gjitha dështimet për të mbajtur shumat e kërkuara.

Neni 11

Përfshirjet nga mbajtja e rezervës së likuiditetit

Bankat që janë shpallur si jo solvente ose në likuidim, duhet të përjashtohen nga mbajtja e minimumit të rezervës së kërkuar të likuiditetit në BQK, që nga data efektive e vendimit të marrë se këto institucione janë jo solvente ose që nga data e inicimit të masave për mbyllje ose likuidim vullnetar si dhe emërimi i likuidatorit. Mjetet në llogaritë e kliringut të bankave mund të rregullohen nga administratorët ose likuidatorët pas prezantimit të kërkesës me shkrim në Departamentin e Mbikëqyrjes Bankare në BQK, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme që e vërtetojnë autorizimin.

Neni 12

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregulla e XVII mbi Minimumin e Obliguar të Mbajtjes së Rezervës së Likuiditetit, do të shfuqizohet.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 16 janar 2012.

Gazmend Luboteni

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës